



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRI I SHETIT  
PËR DIASPORËN

Nr. 762/1 prot,

Datë 9.2.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 915/1 prot,

Datë 9.02.2021



REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

Nr. 234 prot,

Njësia Org. 01/B

Datë 16.02.2021

## URDHËR I PËRBASHKËT

### PËR

## MIRATIMIN E PAKETËS SË DOKUMENTEVE MBI PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË KONKURSIT TË TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN, KRITEREVE PËR RECENSUESIT E TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN DHE SHPALLJEN E KONKURSIT PËR TEKSTET MËSIMORE PËR DIASPORËN

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës datë 23.03.2015 “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë”, si dhe VKM-së nr.756, datë 23.9.2020, “Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën”.

### URDHËROJMË:

1. Me propozim të Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën, në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, datë 23.03.2015, “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë”; bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr. 756, datë 23.9.2020,

“Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën”:

- Miratimin e paketës së dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për Diasporën (*bashkëlidhur*).
  - Miratimin e kriterëve për recensuesit e teksteve mësimore për Diasporën, të cilët do të përzgjidhen nga ministrinë përgjegjëse.
  - Miratimin e shpalljes së konkursit për tekstet mësimore për Diasporën brenda muajit shkurt 2021, nga Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe i Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën.
2. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Kosovës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**EVIS KUSHI**



**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**RAMË LIKAJ**



**MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**PANDELI MAJKO**

